Universiteti i Prizrenit
University of Prizren
Univerzitet Prizrena
"UKSHIN HOTI"
Pranuar me dt. 11.05.2022
Zyra e pranimit 308
Nr. i protokollit 01-190

# Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren

University "Ukshin Hoti" Prizren

## KËSHILLI DREJTUES

Rruga e Shkronjave Nr. 1, 20000 Prizren -Kosovë; Tel:+381 (0) 29- 232 140; Homepage: www.uni-prizren.com

**Kryesues i Këshillit Drejtues**
**Prof. Asoc. Dr. Arif Murrja**

**Prizren, më 11.05.2022**

Në mbështetje të nenit 17, paragrafi 3 të Statutit të Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren, sipas referencës nr. 04-V-621 të datës 30 maj 2013, Këshilli Drejtues i Universitetit të Prizrenit, duke vendosur në lidhje me kërkesën sipas referencës 02 – 81, e datës 15.02.2022, në mbledhjen e mbajtur me datë 28.03.2022, mori këtë:

**V E N D I M**

1. Miratohet kërkesa me nr. prot. 02 – 81, e datës 15.02.2022, parashtruar nga Kujtim Hameli.

2. Përfundon shqyrtimi administrativ i kërkesës me nr. Prot. 02-71, të datës 10.02.2022, parashtruar nga Dekani i Fakultetit Ekonomik, Prof. Asoc. Dr, Halil Kukaj, për kompensimin e z. Kujtim Hameli.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**A r s y e t i m**

Dekani i Fakultetit Ekonomik, Prof. Asoc. Dr, Halil Kukaj ka parashtruar kërkesë në Këshillin Drejtues (Kërkesa me nr. Prot. 02-71, e datës 10.02.2022), për kompensimin e z. Kujtim Hameli, për përkthimin e RVV-së në lidhje me riakreditimin e programit Menaxhment Ndërkombëtar.

Me datë 15.02.2022, Kujtim Hameli ka pashtruar kërkesë në Këshillin Drejtues (Kërkesa me nr. prot. 02-81, e datës 15.02.2022), me çka ka kërkuar anulimin e kërkesës të parashtruar nga Dekani i Fakultetit Ekonomik. Kujtim Hameli në kërkesën e tij potencon se përkthimin e ka bërë në baza vullnetare dhe me motivimin më të lartë për të mirën e Universitetit, prandaj, nuk kërkon ndonjë kompensim.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Prof. Asoc. Dr. Arif Murrja**

Kryesues i Këshillit Drejtues

Vendimi i dërgohet

- Këshillit Drejtues;
- Menaxhmentit;
- Zv. Sekretarit të Përgjithshëm;
- Të përmendurit;
- Arkivit.